REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PEJË

Numri i lëndës: 2020:166844

Datë: 30.11.2021

Numri i dokumentit: 02451729

C.nr. 1515/20

GJYKATA THEMELORE NE PEJE, Departamenti i përgjithshëm , si gjykatë civile e shkalles se parë , me gjyqtaren Merita Baloku, ne çështjen juridike – kontesitmore te paditëseve: L. A. nga ....., K. L. nga fsh. .....Komuna e Pejës, G. M. nga ..... dhe S. M. nga ....., të cilat i përfaqëson F. M. avokat në Pejë, kundër te paditurës: Qendra Kombëtarë e Kosovës për Transfuzioni të Gjakut në Prishtinë, për kompensimin e shpërblimit jubilar, vlera e kontestit: 3762 €, pas përfundimit të shqyrtimit gjyqësor të datës 17.11.2021 në prezencë të autorizuarit të paditëseve dhe të paditurës, gjykata murr dhe përpiloi me datë 30.11.2021, këtë:

A K T G J Y K I M

I. APROVOHET SI E BAZUAR , kërkesëpadia e paditëseve L. A. nga ....., K. L. nga fsh. .....Komuna e Pejës, G. M. nga .....dhe S. M. nga .....

II. DETYROHET e paditura, : Qendra Kombëtare e Kosovës për Transfuzioni të Gjakut në Prishtinë, që paditëses L. A. nga ....., të ia paguaj shpërblimin jubilar për 31 vite, të përvojës së punës në lartësi të tri pagave mujore dhe atë 408.00 x 3 në shumë totale prej 1224.00 €, me kamatë ligjore prej 8% nga data e parashtrimit të padisë me datë 30.11.2020, në afat prej 7 ditësh nga dita e marrjes së këtij aktgjykimi nën kërcënim të përmbarimit me dhunë.

III. DETYROHET e paditura, : Qendra Kombëtare e Kosovës për Transfuzioni të Gjakut në Prishtinë, që paditëses K. L. nga fsh. ....., Komuna e Pejës të ia paguaj shpërblimin jubilar për 10 vite, të përvojës së punës në lartësi të një page mujore dhe atë 408.00€, me kamatë ligjore prej 8% nga data e parashtrimit të padisë me datë 30.11.2020, në afat prej 7 ditësh nga dita e marrjes së këtij aktgjykimi nën kërcënim të përmbarimit me dhunë.

IV. DETYROHET e paditura, : Qendra Kombëtare e Kosovës për Transfuzioni të Gjakut në Prishtinë, që paditëses G. M. nga .....të ia paguaj shpërblimin jubilar për 30 vite, të përvojës së punës në lartësi të tri pagave mujore dhe atë 408.00 x 3, në shumë totale 1224.00 €, me kamatë ligjore prej 8% nga data e parashtrimit të padisë me datë 30.11.2020, në afat prej 7 ditësh nga dita e marrjes së këtij aktgjykimi nën kërcënim të përmbarimit me dhunë.

V. DETYROHET e paditura, : Qendra Kombëtare e Kosovës për Transfuzioni të Gjakut në Prishtinë, që paditëses S. M. nga .....të ia paguaj shpërblimin jubilar për 29 vite të përvojës së punës në lartësi të dy pagave mujore dhe atë 302.00 x 2 në shumë totale 604.00 €, me kamatë ligjore prej 8% nga data e parashtrimit të padisë me datë 30.11.2020, në afat prej 7 ditësh nga dita e marrjes së këtij aktgjykimi nën kërcënim të përmbarimit me dhunë.

2020:166845

VI. REFUZOHET kërkesëpadia e paditëses S. M. nga ....., përtej shumes së aprovuar si në piken V. të dispozitivit të këtij aktgjykimi si jo e bazuar.

VII. DETYROHET e paditura, : Qendra Kombëtarë e Kosovës për Transfuzioni të Gjakut në Prishtinë, që paditëseve të iu paguaj shpenzimet e procedurës në lartësi prej 638 €, në afat prej 7 ditësh nga dita e marrjes së këtij aktgjykimi nën kërcënim të përmbarimit me dhunë

A r s y e t i m

Paditëset, përmes të autorizuarit të tyre, më datë 30.11.2020, kanë parashtruar padi kundër të paditurës Qendra Kombëtare e Kosovës për Transfuzioni të Gjakut në Prishtinë, për kompensimin e pagave jubilare.

Në shqyrtimin kryesor dhe në fjalën e vet përfundimtare e përmes të autorizuarit të tyre paditëset kanë deklaruar se: mbeten në tërësi pranë padisë, kërkesës së saj dhe provave të prezantuara në padi, konfirmon se ka pranuar përgjigjen në padi të ushtruar nga e paditura , të njëjtën e kundërshton pasi që paditëseve bazuar në kontratën kolektive sektoriale të shëndetësisë të dt.12.06.2018 dhe atë nenit 17 ju takojnë paga jubilare sipas viteve të përvojës së punës. Kontestuese nuk mbetet lartësia e këtyre pagave pasi që paga bie sipas kontratës së punës të të gjithë paditëseve . Më tej deklaron se: mbetet në tërësi pranë padisë , kërkesës së saj dhe provave të prezantuara në padi . Paditëseve bazuar në kontratën kolektive sektoriale të shëndetësisë dhe nenit 17 par.3 të dt.12.06.2018 ju takojnë pagat jubilare për vitet e përvojës së punës dhe atë paditëseve sikurse në petitumin e padisë L. A. shuma prej 1224€, për K. L. shuma prej 308€, për G. M. shuma prej 1.224€ dhe për paditësen S. M. shuma prej 906€ , të gjitha këto me kamat ligjore prej 8% nga data e ushtrimit të padisë , kërkojmë nga gjykata që ta aprovoi në tërësi kërkesë padinë e paditëseve dhe shpenzimet e procedurës i kërkon dhe atë: për taksë gjyqësore shumën prej 40€ , për përpilimin e padisë shumën prej 260€ si dhe për një seancë të mbajtur shumën prej 338 apo në shumën të tërësishme prej 638€.

E paditura me Përgjigje në Padi, të ushtruar me dt. 24.12.2020, ka theksuar se në tërësi e kundërshton padinë e paditëseve, si të pa bazuar me arsyet e dhëna si në përgjigje në padi. Në shqyrtimin kryesor dhe në fjalën përfundimtare i autorizuari i të paditurës ka deklaruar se: mbetet pranë përgjigjes në padi, duke kundërshtuar padinë dhe kërkesën e saj si të pabazuar duke konstatuar se ju mungon baza ligjore për realizimin e kësaj të drejte sepse sipas vërtetimeve të M.P. dëshmohet se paditëset kanë arritur jubileun prej 10 viteve pune në kohën kur nuk ka ekzistuar asnjë dispozit ligjore apo rregull autonom për të realizuar shpërblimin jubilar. nga provat e administruara në këtë seancë gjyqësore u vërtetua se kërkesë padia nuk ka bazë ligjore të njëjtën e kundërshtoi edhe për nga lartësia , padia është mbështetur në kontratën kolektive sektoriale për shëndetësi e cila ka hyrë n fuqi me dt.12.06.2018 në të cilën në asnjë dispozitë ligjore nuk parasheh veprim retroaktiv për realizimin e të drejtës sipas kërkesë padisë e që paditëset jubileun e kanë arritur në kohën kur nuk ka ekzistuar asnjë dispozitë ligjore e që me rastin e parashtrimit të padisë në këtë gjykatë konstaton se është parashkruar. Padia e mbështetur në kontratën kolektive sektoriale kjo kontratë parasheh të drejtën dhe detyrimet për punonjësit shëndetësor e që paditësja S. M. në pozitë të punës është higjieniste këtu vlerësojmë se i mungon baza ligjore. Po ashtu të njëjtës nga vërtetimi i M.P. konstatohet se ka 29 vite të përvojës së punës. Duke mbetur në përgjigjen në padi dhe thënieve të lartë cekura i propozojmë gjykatës që padinë dhe kërkese padinë ta refuzoi në tërësi si të pabazuar. Shpenzimet e procedurës nuk i kërkoi.

Gjykata për vërtetimin e plote të gjendjes faktike në ketë çështje juridike –kontestimore, zhvilloj procedurën e provave dhe ka administruar këto prova: vërtetimin e M.p.

2020:166845

nr.77/2020/18.02.2020, kontrata e punës për kohë të caktuar për L. A., i dt.132 i dt.01.04.2016, bëri shikimin e pasqyrës bankare për paditësen L. A., lexohet vërtetimi i M.P. për K. L. me nr.73/2020 e dt. 18.02.2020, kontrata pe punës për kohë të pacaktuar për K. L. e dt. 05.01.2015, pasqyra e bankës NLB për Kosovare Lulaj, vërtetimi i M.P. për G. M. me nr.78/2020 e dt. 18.02.2020, kontrata pe punës për kohë të pacaktuar për G. M. e dt. 05.01.2015, llogaria bankare në NLB Bankë për G. M. , vërtetimi i M.P. për S. M. , me nr.71/2020 e dt. 18.02.2020, kontrata pe punës për kohë të pacaktuar për S. M. j e dt. 05.01.2015, pasqyra bankare e BKT Bankë për S. M. j, bëri shikimin në L.Nj. e paditëseve, lexoi shkresat tjera të lëndës C.nr. 1515/20.

Nga provat e administruara e në veçanti nga vërtetimi me M.p. nr.77/2020/18.02.2020, është vërtetuar fakti se nga datat 13.10.1988 e gjer me datën 31.12.2014 , paditësja L. A. është angazhuar te paditura , si infermiere në marrëdhënie pune në kuadër të Qendrës Medicinale dhe Kabineti i Transfuzionit të Gjakut në Spitalin e Përgjithshëm në Pejë. Ndërsa nga data 01.01,2015 vazhdon të punoj si Teknike e Transfuzionit në institucionin Qendra Kombëtare e Kosovës për transfuzionin e gjakut në Pejë, e cila gjithsejtë ka përvojë pune prej 31 vite 1 muaj dhe 17 ditë dhe realizon të ardhura mujore prej 408 €.Kjo gjendje u vërtetu edhe nga pasqyra bankare Raiffeisen Bankë dhe Kontrata Punës në Kohë të Caktuar me nr.132 e datës 01.04.2016.

Nga provat e administruara e në veçanti nga vërtetimi me Marrëdhënies së Punës nr.71/2020/ të dates 18.02.2020, është vërtetuar fakti se nga datat 01.06.1989 e gjer me datën 31.12.2014, paditësja K. L. është angazhuar ta e paditura si infermiere në marrëdhënie pune në kuadër të Qendrës Medicinale dhe Kabineti i Transfuzionit të Gjakut në Spitalin e Përgjithshëm në Pejë. Ndërsa nga data 01.01,2015 vazhdon të punoj si Teknike e Transfuzionit në institucionin Qendra Kombëtare e Kosovës për transfuzionin e gjakut në Pejë, e cila gjithsejtë ka përvojë pune prej 10 vite 5 muaj dhe 17 ditë dhe realizon të ardhura mujore prej 408 €. Kjo gjendje u vërtetu edhe nga pasqyra bankare në NLB Bankë dhe Kontrata Punës në Kohë të Pacaktuar me nr.130 e datës 05.01.2015.

Nga provat e administruara e në veçanti nga vërtetimi me Marrëdhënies së Punës nr.78/2020 të dates 18.02.2020, është vërtetuar fakti se nga datat 01.09.2009 e gjer me datën 31.12.2014, paditësja G. M. është angazhuar ta e paditura si infermiere në marrëdhënie pune në kuadër të Qendrës Medicinale dhe Kabineti i Transfuzionit të Gjakut në Spitalin e Përgjithshëm në Pejë. Ndërsa nga data 01.01,2015 vazhdon të punoj si Teknike e Transfuzionit në institucionin Qendra Kombëtare e Kosovës për transfuzionin e gjakut në Pejë, e cila gjithsejtë ka përvojë pune prej 30 vite 7 muaj dhe 17 ditë dhe realizon të ardhura mujore prej 408 €. Kjo gjendje u vërtetu edhe nga pasqyra bankare në NLB Bankë dhe Kontrata Punës në Kohë të Pacaktuar me nr.140 e datës 05.05.2015.

Nga provat e administruara e në veçanti nga vërtetimi me Marrëdhënies së Punës nr.71/2020/ të dates 18.02.2020, është vërtetuar fakti se nga datat 01.01.2004 e gjer me datën 31.12.2014, paditësja S. M. është angazhuar te e paditura si Hixhieniste në marrëdhënie pune në kuadër të Qendrës Medicinale dhe Kabineti i Transfuzionit të Gjakut në Spitalin e Përgjithshëm në Pejë. Ndërsa nga data 01.01,2015 vazhdon të punoj si Teknike e Transfuzionit në institucionin Qendra Kombëtare e Kosovës për transfuzionin e gjakut në Pejë, e cila gjithsejtë ka përvojë pune prej 29 vite 7 muaj dhe 17 ditë dhe realizon të ardhura mujore prej 302 €. Kjo gjendje u vërtetu edhe nga pasqyra bankare në BKT NJËSIA Teuta në Pejë dhe Kontrata Punës në Kohë të Pacaktuar me nr.137 e datës 05.01.2015.

Nga provat tjera të administruara siç janë kërkesat e paditëseve: nr. 244/2020 e datës 16.07.2020, 251/2020 e datës 16.07.2020, nr. 250/2020 e datës 16.07.2020, e datës 25.06.2020,

dhe nr.249/2020 e datës 16.07.2020. dhe provave tjera, provohet fakti se paditëset kanë shtjerrë mjetet e brendshme juridike për të kërkuar të drejtën e tyre që pretendojnë se iu takon sipas Kontratës Kolektive Sektoriale për Shëndetësi.

Andaj nga provat e administruara, gjykata gjeti se kërkesëpadia e paditëseve janë të bazuara, ligjërisht dhe se përgjegjësia për kompensim e pagave jubilare bie mbi të padituren, nga se kërkesa e palës paditëse gjen mbështetje në nenin 17.2.3 të Kontratës Kolektive Sektoriale, me nr. 05- 3815, të datës 12.06.2018, i cili nen parasheh se punëtoret shëndetësorë në vitet jubilare të punësimit përfitojnë shpërblimin jubilar nga punëdhënësi i fundit e në bazë të pagës bazë. Duke qenë se, Kontrata Kolektive Sektoriale e cekur veç tjerash është nxjerr edhe konform nenit 90 par. 1 në par 1.1 dhe paragrafi 2 të Ligjit të Punës nr. 03/L-2012, i cili nen parasheh Marrëveshjen Kolektive, bazuar në këtë kjo gjykatë vlerëson se kërkesa e paditësve për shpërblimin jubilar e aprovuar nga gjykata gjen mbështetje edhe në nenin 20 të Kontratës së Punës me Nr. prot. 144/12 të datës 31.12.2012, andaj bazuar në të cekurat gjykata e aprovoi kërkesëpadinë e paditëses dhe vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Me rastin e vendosjes gjykata pati parasysh kundërshtimet e të padituës mirëpo të njëjtat nuk ishin me ndikim për të vendosur ndryshe.

Vendimin mbi shpenzimet e procedurës gjykata e vendosi duke u mbështetur ne dispozitën e nenit 452 par.1, nenit 463.1 të LPK-së, e sipas tarifës se OAK-ës, në këto shpenzime janë llogaritur: për përpilimin e padisë shuma prej 260 €, për taksen gjyqësore shumen prej 40 €, për përfaqësim për një seance shumen prej 338 €, e në shumë totale prej 638 €.

Nga arsyet e lartcekura u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Nga Gjykata Themelore në Pejë, C.nr. 1515 /20 me datë 17.11.2021

G j y q t a r j a
Merita Baloku

KËSHILLA JURIDIKE
Kundër këtij aktgjykimi palët kanë te drejtë ankese
në afat prej 15 ditësh, nga dita e marrjes, në Gjykatën
e Apelit të Kosovës, e përmes kësaj gjykate.